



Akreditohet Universiteti i Tiranës, Prof. Dr. Mynyr KONI: Vlerësimi, rezultat i punës kërkimore dhe shkencore.

Klikoni mbi link për të ndjekur intervistën,

<http://www.oranews.tv/article/akreditohet-universiteti-i-tiranes-koni-vleresimi-rezultat-i-punes-mesimore-dhe-kerkimore>

Nga: **Erblina Mile**

23/11/2018 - 16:27

Universiteti i Tiranës është vlerësuar pozitivisht nga Agjencia e Sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, duke u akredituar për 4 vitet e ardhshme. Rektori, Mynyr Koni, thotë se ky vendim pozitiv është rezultat i punës mësimore dhe kërkimore i stafit akademik.

Universiteti i Tiranës është akredituar nga Agjencia e Sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, në të gjitha degët për një periudhë 4 vjeçare. Pas nështrimit të këtij procesi periodik, cilësia në Universitetin e Tiranës është vlerësuar si pozitive, ndërsa rektori, profesor doktor Mynyr Koni, e vlerëson këtë moment si tejet të rëndësishëm.

Prof. Dr. Mynyr Koni: *Kjo ka ardhur si rrjedhojë e një pune të palodhur të të gjithë strukturave të UT, të senatit akademik, të rektoratit, të drejtuesve të njësisë kryesore dhe në mënyrë të veçantë një punë e palodhur e grupit të vlerësimit të brendshëm, i cili ka punuar me përkushtim për të përgatitur një raport dinjitoz.*

Ky vlerësim sipas rektorit Koni lidhet dhe me aktivitetet mësimore dhe konferencat shkencore që organizohem nga Universiteti i Tiranës. Në këtë kuadër, në Akademinë e Shkencave u mbajt konferenca ndërkombëtare e biotknologjisë.

Prof. Dr. Mynyr Koni: *Është një risi dhe me pasuri të kërkimeve shkencore ku marrin pjesë dhe përfaqësues dhe studiues nga vende të ndryshme të Europës, të cilët i japin një dimension të ri. Ajo që është e rëndësishme, që në këtë departament aktiviteti përfshin një dimension të gjerë.*

Në ditët e ardhshme në Tiranë do të mbahet edhe konferenca ndërkombëtare e informatikes duke dokumentuar, sipas rektorit Mynyr Koni, një nga standardet e rëndësishme që është kërkimi shkencor.